FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për përdoruesin

ALEFAST

Tableta të veshura me film – 120 mg, 180 mg
(Feksofenadinë klorhidrat)

Lexojeni me kujdes të gjithë këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit, sepse përmban informacione të rëndësishme për ju.

- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se keni efekte anësore, njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj. Kjo përfshin edhe efekte anësore që nuk janë të renditur në këtë fletëudhëzues. Shikoni pikën 4.

Në këtë fletëudhëzues:

1. Çfarë është Alefast dhe përse përdoret
2. Çfarë duhet të dini përpara se të merrni Alefast
3. Si ta merrni Alefast
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Alefast
6. Informacione të mëtejshme

1. ÇFARË ËSHTË ALEFAST DHE PËRSE PËRDORET

Alefast përmban lëndën vepruese feksofenadinë klorhidrat, e cila bën pjesë në grupin e barnave të quajtur antihistaminikë.
Tabletat Alefast 120 mg përdoren tek të rriturit dhe adoleshentët mbi 12 vjeç për lehtësimin e simptomave që shkaktohen nga riniti alergjik stinor, si: teshtima, rrjedhje dhe kruarje hunde, kruarje sysh, lotim dhe skuqje në fytyrë.

Tabletat Alefast 180 mg përdoren tek të rriturit dhe adoleshentët mbi 12 vjeç për lehtësimin e simptomave që shkaktohen nga reaksionet alergjike të lëkurës (urtikaria kronike idiopatike), si: skuqje, enjtje dhe kruarje.

2. ÇFARË DUHET TË DINI PËRPARA SE TË MERRNI ALEFAST

Mos merrni Alefast në qoftë se:

- jeni i ndjeshëm **(alergjik)** ndaj feksofenadinës klorhidrat ose ndaj ndonjërit prej përbërësve të tjerë të tabletave Alefast.

Ky bar nuk rekomandohet për fëmijë nën 12 vjeç.

Paralajmërime dhe masa paraprake

Flisni me mjekun ose farmacistin tuaj para se të përdorni këtë bar në qoftë se:

- keni probleme me veshkat apo mëlçinë;
- keni apo keni patur sëmundje të zemrës, pasi marrja e këtij bari mund të shkaktojë një ritëm të shpejtë ose të çrregullt të rrahjes së zemrës;
- jeni i/e moshuar;
- jeni epileptik.

Testet e alergjisë: në qoftë se do bëni një test alergjie, marrja e këtij bari duhet të ndërpritet 3 ditë para kryerjes së testit.

Barna të tjerë dhe Alefast

Kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë, keni marrë kohët e fundit apo mund të merrni barna të tjerë.
Është veçanërisht e rëndësishme që të flisni me mjekun tuaj para se të merrni Alefast, nëse po merrni ndonjërin prej barnave të mëposhtëm:

- eritromicinë (antibiotik i përdorur për trajtimin e infeksioneve të caktuara bakteriale);
- ketokonazol (bar i përdorur për trajtimin e infeksioneve mykotike);
- lopinavir / ritonavir (barna të përdorur për trajtimin e infeksionit të HIV).

Këto barna rrisin sasinë e përthithur të tabletave Alefast, duke rritur kështu efektet anësore që ju mund të keni.

Barnat për problemet me tretjen që përmbajnë alumin dhe magnez mund të ndikojnë mbi veprimin e Alefast duke ulur sasinë e barit të përthithur. Nëse jeni duke marrë barna të tillë, është e rekomanduar të prisni rreth 2 orë ndërmjet kohës së marrjes së Alefast dhe barit për problemet me tretjen.

Marrja e Alefast me ushqim dhe pije

Tabletat Alefast duhet të merren me ujë. Lëngjet e frutave, duke përfshirë lëngun e grejpfrutit, mund të zvogëlojnë biodisponibilitetin e feksofenadinës, prandaj përdorimi i njëkohshëm i tyre duhet shmangur. Shmangni përdorimin e pijeve alkolike.

Shtatzënia

Nëse jeni shtatzënë, mendoni se mund të jeni shtatzënë apo planifikoni të keni fëmijë, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj për kështillë para se të merrni Alefast.
Ju mund të merrni Alefast gjatë shtatzënisë vetëm në qoftë se mjeku juaj mendon se është rreptësisht e nevojshme.

Ushqyerja me gji

Nuk rekomandohet të merret Alefast në qoftë se po ushqeni me gji.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive

Nuk ka shumë gjasa që Alefast të ndikojë mbi aftësitë për të drejtuar automjetin apo përdorimin e makinerive. Megjithatë mund të ketë përjashtime të rralla, kështu që ju duhet të siguroheni që këto tableta nuk ju shkaktojnë gjendje të përgjumur ose marrje mendsh para se të drejtoni automjetin ose të përdorni makineri.

3. SI TA MERRNI ALEFAST

Gjithmonë merrini tabletat Alefast sipas këshillës së mjekut ose farmacistit. Pyesni mjekun apo farmacistin tuaj nëse nuk jeni i/e sigurt.

Tabletat Alefast 120 mg

Për lehtësimin e simptomave të rinitit alergjik stinor, doza e rekomanduar është një tabletë, një herë në ditë, për të rritur e fëmijë mbi 12 vjeç.

Tabletat Alefast 180 mg

Për lehtësimin e simptomave të urtikaries idiopatike kronike, doza e rekomanduar është një tabletë, një herë në ditë, për të rritur e fëmijë mbi 12 vjeç.

Merrini tabletat me ujë, para ushqimit.
Nëse mendoni se efektet e Alefast janë shumë të forta ose shumë të dobëta, ju lutemi të pyesni mjekun ose farmacistin juaj.

Në qoftë se keni marrë më shumë Alefast sesa duhet

Kontaktoni me mjekun, urgjencën më të afërt ose farmacistin nëse keni marrë më shumë Alefast sesa thuhet në këtë fletëudhëzues apo më shumë se sa ka përshkruar mjeku juaj. Simptomat e mbidozimit përfshijnë marrje mendsh, përgjumje, lodhje dhe tharje goje.

Në qoftë se keni harruar të merrni Alefast

Mos merrni një dozë të dyfishtë për të plotësuar dozën e harruar.
Në qoftë se harroni një dozë, merrni dozën në vazhdim kur të jetë koha për marrjen e zakonshme të saj.

Në qoftë se ndërprisni trajtimin me Alefast

Njoftoni mjekun tuaj nëse doni të ndërprisni marrjen e Alefast para se të keni përfunduar trajtimin tuaj.
Nëse ndaloni së marri Alefast më herët, simptomat mund t'ju rikthehen.
Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij produkti, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Si të gjithë barnat, Alefast mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse ato nuk shfaqen tek të gjithë.
Njoftoni menjëherë mjekun dhe ndërprisni marrjen e tabletave Alefast nëse ju shfaqen:

- Enjtje në fytyrë, buzë, gjuhë ose fyt apo vështirësi në frymëmarrje, pasi këto mund të jenë shenja të një reaksioni alergjik serioz.

Efektet anësore të mundshme të renditura më poshtë, sipas shpeshtësisë përcaktohen si:

- **Efekte anësore të zakonshme** (mund të preken deri 1 në 10 njerëz):
  Dhimbje koke, përgjumje, nauze, marrje mendsh.
- **Efekte anësore të pazakonta** (mund të preken deri 1 në 100 njerëz):
  Ndjesi lodhjeje, shikim i turbullt, tharje goje, shqetësime gastrointestinale, çrregullime psikomotore, vështirësi në urinim.
- **Efekte anësore të rralla** (mund të preken deri 1 në 1,000 njerëz):
  Anafilaksi, angioedema, glaukomë me kënd të mbyllur (tek të rriturit), aritmi, çrregullime të gjakut, bronkospazmë, konfuzion, konvulsione, depresion, marrje mendsh, efekte ekstrapiramidale, reaksione mbindjeshmërie, hipotension, çrregullim i funksionit të mëlçisë, rrahje të forta dhe/ose të shpeshta zemre, reaksione të ndjeshmërisë ndaj dritës, skuqje e lëkurës, shqetësime të gjumit, dridhje.
- **Efekte anësore të tjera** (shpeshtësia nuk njihet, nuk mund të përcaktohet nga të dhënat e disponueshme):
  Vështirësi për të fjetur, çrregullime të gjumit, makthe, nervozizëm, diarre, skuqje dhe kruarje të lëkurës, urtikarie, reaksione alergjike serioze që mund të shkaktojnë enjtje të fytyrës, buzëve, gjuhës ose fytit dhe vështirësi në frymëmarrje.

5. SI TA RUANI ALEFAST

Ruajeni barin larg fëmijëve!
Mos i përdorni tabletat Alefast pas datës së skadencës, e cila është e shënuar në paketim.
Mos i ruani tabletat mbi 25°C!
Ruajini në paketimin origjinal për t'i mbrojtur nga drita dhe lagështira.

6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Çfarë përmbajnë tabletat e veshura me film Alefast

Lënda aktive është feksofenadinë klorhidrat.
1 tabletë e veshur me film përmban 120 mg ose 180 mg feksofenadinë klorhidrat.

Lëndët ndihmëse janë:
bërthama e tabletës: celulozë mikrokristalore, amidon misri, kroskarmelozë natriumi, povidon, stearat magnezi;
veshja me film: Opadry II i bardhë (alkool polivinilik, dioksid titani, makrogol, talk).

Përmbajtja e paketimit

Alefast 120 mg:	kuti me 10 tableta të veshura me film, kuti me 20 tableta të veshura me film.
Alefast 180 mg:	kuti me 10 tableta të veshura me film, kuti me 20 tableta të veshura me film.

Mbajtësi i autorizimit të tregtimit dhe prodhuesi:

PROFARMA sh.a.,
Rruga "Skënder Vila",
Tiranë, Shqipëri.
Tel.: +355 4 23 89 602

Ky fletudhëzues u rishikua për herë të fundit në Tetor 2023.

SPECIFICATION

CROPING AREA 12 x 19 cm

PAY ATENTION, all the layers are visible.
If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.